

Lulzim ALIU

SHMANGIA E PËRDORIMIT TË GJUHËS LETRARE SHQIPE NË MEDIAT SHQIPTARE

UDC 811.18'26:316.774

Abstrakti: Mediat, si mjete bashkëkohore të shprehjes dhe komunikimit kulturor e gjuhësor, përbëjnë një nga hapësirat e detyrueshme ku shqipja standarde duhet të zotërohet e të promovohet. Me njësimin e shqipes në Kongresin e Drejtshkrimit më 1972, e paraprakisht me Konsultën e Prishtinës më 1968, standardi i shqipes u përqaftua e u mbështet si variant zyrtar i përdorshëm në të gjitha sferat publike institucionale e arsimore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e në Luginën e Preshevës. Realiteti i sotëm dëshmon për një nivel zotërimi e përdorimi të pakënaqshëm të standardit kundrejt trajtave dialektore ose të folmeve krahinore apo edhe fjalëve të huaja, veçoritë e të cilave i hasim dendur në domenin mediatik.

Njëra nga fushat që, gjithsesi, ndikon në ndërgjegjësimin gjuhësor të problemeve të ndryshme shoqërore, padyshim janë mediat. Me mediat secili nga ne është në kontakt gjatë gjithë ditës: si me ato të shkruara, gazetatat ditore ose periodike, revistat, po ashtu edhe me mediat elektronike, televizioni, radioja, interneti etj. Të gjitha ngjarjet që ndodhin në vend a në botë, si dhe të gjitha aktivitetet e tjera nga fusha e kulturës, shkencës, sportit etj. transmetohen te lexuesi apo dëgjuesi kryesisht nëpërmes gjuhës. Pra, kur jemi te gjuha, mund të bëhet pyetja: Sa jemi kritik për atë se si po e flasim, apo po e shkruajmë atë? Kjo çështje në rend të parë i vë në përgjegjësi njerëzit që direkt apo indirekt merren me gjuhë. Nuk mjafton që me gjuhë të merren vetëm gjuhëtarët, siç, ndoshta, mund të mendojë ndokush. Gjuha është e të gjithëve. Duke e pasur parasysh, mungesën e një ndërgjegjësimi jo të mjaftueshëm gjuhësor të kësaj kategorie intelektualësh, gabime të tilla në mediat tona, po dalin për ditë e më shumë.

Ky punim synon të sjellë një pasqyrë të gjendjes reale të përdorimit të standardit nga folësit e prezantuesit në disa nga transmetuesit elektronikë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. Do të përpiqemi të sjellim përgjigje për shkallën e përdorimit të standardit, ndikimin e formimit gjuhësor të të ftuarve ndaj prezantuesve, nivelin e zotërimit të standardit nga folësit e prezantuesit, përkushtimin e tyre për ta përdorur korrektësisht normën e shqipes standarde dhe tipologjinë e emisioneve, si diktuese të përdorimit të standardit dhe të trajtave dialektore.

Fjalë kyçe: gjuhë standarde, media, dialekt, veçori fonetike, të folme

SWERVE IN USAGE OF ALBANIAN STANDARD LANGUAGE IN ALBANIAN MEDIA

Abstract: Media, as contemporary tools of cultural and linguistic expression and communication, constitute one of the mandatory spaces where standard Albanian must be mastered and promoted. With the unification of the Albanian language in the 1972, Congress of standard writing, previously with the Prishtina Consultation in 1968, the standard of Albanian language was embraced and supported as an official variant of use in all public and educational spheres in Albania, Kosovo, Macedonia, Montenegro and in the Preshevo Valley. Today's reality testifies to a level of unsatisfactory use and use of the standard versus dialectical or provincial or foreign words, the features we find in the media domain.

One of the areas that, however, affects the linguistic awareness of various social problems, are undoubtedly the media. With the media, each of us is in touch every day: as with the written ones, daily or periodical newspapers, magazines, as well as with electronic media, television, radio, internet etc. All events that take place in the

country or in the world, as well as all other activities in the field of culture, science, sport etc. are transmitted to the reader or listener mainly through the language. So when we are talking about the language, the question may be: How critical we are for that how we talking or how we writing it? This issue firstly takes into responsibility people which directly or indirectly are dealing with languages. It is not enough for language to speak only linguists, as perhaps someone can think. The language is everyone's. In regard of that, the lack of inadequate linguistic awareness of this category of intellectuals, such mistakes in our media, are emerging for more and more days.

This paper aims to provide an overview of the realistic state of usage of the standard language by the speaker's in some of the broadcasters in Albania, Kosovo and Macedonia. We will try to answer the scale of usage of standard language, the impact of the language use of the guests on the presenters, the level of standard ownership by the speakers of the presenter, their commitment to correctly use the standard Albanian language and the typology of the programs, such as distinctive of standard usage and dialectal shapes.

Key words: *standard language, media, dialect, phonetic, spoken language.*

Gjuha si mjet komunikimi është një fushë që na prek të gjithë, qoftë edhe jashtë interesave të ngushta profesionale të secilit. Gjuha shqipe si një nga aspektet më të rëndësishme të kulturës dhe identitetit tonë kombëtar ka pësuar ndryshime të mëdha. Kështu, duke pasqyruar ndryshimet në fushat e tjera të shoqërisë, gjuha shqipe është zhvilluar duke përfshirë në fjalorin e saj shumë fjalë të reja ndonjëherë të krijuara nga fondi i saj ekzistues dhe shpeshherë të huazuara nga gjuhë të tjera.

Në këtë proces të zhvillimit të gjuhës shqipe mediat kanë një rol kryesor si përçues të informacionit tek njerëzit. Fatkeqësisht, mediat shqiptare në vend që të ndihmojnë në pasurimin dhe ruajtjen e vlerave tona gjuhësore po e keqpërdorin dhe po abuzojnë me gjuhën. Në këtë punim do të përqendrohemi në zhvillimet e gjuhës shqipe në vitet e fundit dhe (keq)përdorimin e saj nga mediat.

Njëra nga fushat që, gjithsesi, ndikon në ndërgjegjësimin gjuhësor të roleve të ndryshme shoqërore, padyshim janë mediat. Me media secili nga ne është në kontakt gjatë gjithë ditës: si me ato të shkruara, gazetat ditore ose periodike, revistat, po ashtu edhe me mediat elektronike, televizionin, radioja, internetin etj. Të gjitha ngjarjet që ndodhin në vend a në botë, si dhe të gjitha aktivitetet e tjera nga fusha e kulturës, shkencës, sportit etj. transmetohen te lexuesi apo dëgjuesi kryesisht nëpërmes gjuhës.

Gjuha e medieve - një shqipe e pastër apo hibridizim i panevojshëm?

Me keqardhje duhet vënë në pah se shpesh ne si shqiptarë ngatërrojmë dëshirën për t'u integruar në Evropë dhe për të arritur nivele e vlera evropiane me pranimin apo parapëlqimin e gjithçkaje të huaj mbi atë shqiptare. Në veçanti njerëzit publikë tregohen të pakujdesshëm dhe gabojnë për dy arsye me përdorimin e shqipes: e para, sepse nuk e njohin forcën, bukurinë dhe mundësitë e gjuhës sonë; e dyta, është një kompleks inferioriteti që kanë ata, pasi mendojnë se, duke përdorur fjalë të huaja, do të jemi më afër Evropës.

Në asnjë mënyrë integrimi në Evropë dhe standardet evropiane nuk duhet të njehsohet me humbjen e vlerave dhe identitetit tonë si shqiptarë. Këtë humbje vlerash po e hasim gjithnjë e më shpesh, madje nuk do ishte e tepruar po të thoshim që ndodh çdo ditë teksa lexojmë gazetat shqiptare të mbushura plot me fjalë të huaja, teksa shohim programet televizive që tashmë edhe titujt nuk i kanë

më shqip apo tek dëgjojmë politikanët tanë të flasin me një gjuhë hibride ku më shumë të bën përshtypje larmia e fjalëve të huaja se sa atyre shqip.

Është për të ardhur mirë që shqiptarët zotërojnë dhe janë në gjendje të komunikojnë në gjuhë të huaja dhe t'i përdorin ato në dobi të profesioneve të tyre. Është për të ardhur mirë që politikanët tanë lexojnë dhe mësojnë nga vendet e tjera apo që gazetarët dhe folësit e televizioneve kanë njohuri të gjuhëve dhe kulturave të tjera. Njëherazi është për të ardhur keq që këto njohuri të tyre që mund të përdoren për pasurimin e mëtejshëm të gjuhës po përdoren për dëmtimin e saj. Përse duhet që gazetarët apo folësit tanë të përdorin fjalën “*lider*” në vend të fjalës udhëheqës, fjalën “*atakoj*” në vend të fjalës sulmoj, “*starton*” në vend të fjalës fillon, “*atribut*” në vend të fjalës cilësi e shumë shembuj të tjerë që të shqetësojnë dhe të acarojnë njëkohësisht?

Duhet theksuar se jemi të ndërgjegjshëm se zhvillimet e reja në shoqërinë shqiptare kanë sjellë fjalë të reja që nuk kanë qenë pjesë e pasurisë leksikore të shqipes. Gjithashtu, duhet të jemi të ndërgjegjshëm që gjuha është gjithnjë në zhvillim dhe nuk do të ishte reale të prisnim që për çdo fjalë apo shprehje në një gjuhë të huaj të kishim një tjetër në shqip. Nuk duhet kaluar në një pastrim të skajshëm. Është e kuptueshme që procesi i hyrjes së fjalëve të huaja në shqip është normal dhe i pranueshëm.

Ka mjaft raste kur kjo është e pashmangshme pasi ka dukuri e fjalë për të cilat nuk ekziston një fjalë në shqip. Një nga këto fjalë është fjala angleze “*background*” që megjithëse ne kemi një fjalë në shqip për të sfond, përsëri vetëm kjo fjalë nuk e përmbush spektrin e kuptimeve të kësaj fjale në anglisht.

Futja e fjalëve të huaja është një dukuri e natyrshme që ka të bëjë me zhvillimin e gjuhës dhe jo çdo futje e një fjale të huaj në shqip duhet konsideruar si e gabuar apo dëmtuese. Shkëmbimet mes gjuhëve dhe kulturave nuk bëjnë gjë tjetër veçse i pasurojnë ato më tepër. Vetëm se duhet pasur kujdes të mos ngatërrohet kjo me atë që po ndodh sot me gjuhën shqipe kur po përdoren gjithnjë e më shumë fjalë të huaja në mënyrë të panevojshme edhe atëherë kur ekzistojnë fjalët shqipe duke treguar një pakujdesi apo përbuzje të vlerave ekzistuese që po çon në krijimin e një gjuhe mediatike të hibridizuar që qëndron shumë larg shqipes standarde.

A përdoret shqipja standarde në televizionet shqiptare?

Në të gjithë televizionet tona një hapësirë e rëndësishme i lihet lajmit dhe politikës në vend. Për këtë arsye, shihet e arsyeshme të fillohet nga ata të cilët kanë në dorë çdo politikë që shteti ynë përpilon për të drejtuar shoqërinë shqiptare. Është e pashmangshme dhe politikanët duhet të fajësohen përsëri, sepse ata jo vetëm nuk kërkojnë llogari tek vartësit e tyre për gjendjen e mjerueshme drejt së cilës gjuha jonë ka marrë kah, por ata po e përkrahin dhe po e praktikojnë këtë mjerim.

Gjuha shqipe shkelmohet nga shtresa më e lartë e shtetit (Shteti shqiptar, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi), dhe si rrjedhojë për qytetarin shqiptar krijohet një “konfuzion” vetëvrasës. Parlamenti duhet të jetë Tempulli i Shqiptarisë duke vijuar me konferencat e deklaratat për shtyp ku politikanët tanë shprehin mendimet e tyre për çdo zhvillim.

Le të përqendrohemi më në detaje tani tek pushteti i katërt, mediat që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën e të menduarit të çdo shoqërie. Kjo forcë që luan rolin e ndërmjetësuesit dhe përçuesit të informacionit mes shtetit dhe qytetarit ka një fuqi të jashtëzakonshme ndikimi në kultivimin, mirëmbajtjen dhe pasurimin e vlerave kulturore në përgjithësi dhe atyre gjuhësore në veçanti.

Në kohën e sotme mediat po luajnë më tepër një rol negativ për sa i përket ruajtjes së vlerave dhe identitetit tonë shqiptar. Kjo ndodh sepse armata e gazetarëve, redaktorëve, folësve dhe gjithë atyre

që janë përgjegjës për kalimin e informacionit tek qytetarët janë të parët që nuk përdorin gjuhën standarde dhe që e mbingarkojnë gjuhën me fjalë të huaja të panevojshme.

Për të përfunduar me televizionet si një nga mjetet kryesore të përçimit të informacionit do të marrim disa shembuj nga kanali publik shqiptar “TVSH”. Në këtë kanal ke mundësi të dëgjosh gazetarët e vjetër të cilët flasin një shqipe të kulluar, por gjithashtu mund të dëgjosh gazetarë të tjerë që flasin një shqip-anglishte tashmë.

Gjithashtu, në TVSH, gabime të tilla dhe të shumta bëjnë edhe gazetarë e prezantues të tjerë, si për shembull, drejtuesi i mirënjohur Adi Krasta që drejton “Krasta Show”, për të cilin jo vetëm ka zgjedhur një fjalë të huaj për të emërtuar shfaqjen, por madje përdor shumë fjalë të huaja si: “perceptime”, “influencojnë”, “suportojnë”, etj.

Përdorimi apo keqpërdorimi i gjuhës shqipes në gazeta

Të njëjtin shqetësim lidhur me fluksin e pandërprerë dhe të panevojshëm të fjalëve të huaja në shqip e ndien edhe kur lexon gazetatat.

Nga vështrimi që iu bë gazetave shqipe vihet re se çdo ditë përdoren me dhjetëra fjalë të huaja të panevojshme për të cilat ekziston një variant i mirëfilltë në shqip. Disa nga shembujt janë: përdorimi i fjalës “*destinacion*” në vend të vendmbërritje, “*dekorativ*” në vend të zbukurues, “*slogane*” në vend të fjalës parulla, “*opsione*” në vend të fjalës mundësi, “*oponent*” në vend të fjalës kundërshtar, “*impakt*” në vend të fjalës ndikim. Parapëlqehet të përdoret fjala “*atraktive*” në vend të fjalës tërheqëse, fjala “*luk*” në vend të fjalës paraqitje, “*implementim*” në vend të fjalës zbatim, “*asistuar*” në vend të fjalës ndihmuar, “*permanente*” në vend të fjalës e përhershme, “*network*” në vend të fjalës rrjet etj.

Natyrshtëm lind pyetja se çfarë pune bëjnë redaktorët e këtyre gazetave që lejojnë botimin e këtyre shkrimeve plot gabime dhe nëse kjo nuk është puna e tyre atëherë pse të mos kenë gjithë gazetatat një specialist apo korrektor gjuhësor siç kanë shtëpitë botuese?

Lista e fjalëve të huaja të përdorura në mediat shqiptare:

fjala e huaj	fjala shqipe	media
Atakohet	Sulmohet	Top Channel
Access	Hyrje	Top Channel
Currente	Aktuale	Top Channel
Asset	Pasuri	Top Channel
Vulnerable	i pambrojtur	Top Channel
Genrin	Rryma	Top Channel
Mixuar	Përzier	Top Channel
Nucleare	Bërthamore	Top Channel
Contestuar	Kundërshtuar	Top Channel
Compilation	përmbledhje	Top Channel
Boilera	ujëngrohës	Top Channel
Task Force	grup pune	Top Channel
Coshient	i vetëdijshëm	Top Channel
Artikulluar	i shprehur	Top Channel
Komplex	i/e komplikuar	Top Channel
NGO-ve	OJQ- ve	Top Channel
Vishin List	lista e dëshirave	Top Channel
Konfuzion	Rrëmuje	TVSH
Celebrime	Festime	TVSH
Barrierat	Pengesë	TVSH
Perversitet	Banale	Alsati
Paprecedente	i/e paparë	Alsati
Celebruam	Festuem	Alsati
Liderë	Udhëheqës	Alsati
Starton	Fillon	Alsati
Atributet	Veçoritë	Alsati
Rutine	Zakon	Alsati
Evituar	Shmangur	Parlamenti
Eskortuar	Shoqëruar	Parlamenti
Donacion	Dhurim	Gazeta Shqiptare
Destinacion	Vendmbërritje	Gazeta Shqiptare
Dekorative	Zbukurues	Gazeta Shqiptare
Negociatat	bashkëbisedimet	Gazeta Shqiptare
Bum	Rritje	Gazeta Shqiptare
Intensiv	I shpeshtë	Gazeta Shqiptare
Grant	Fond	Gazeta Shqiptare
Slogan	Parulla	Gazeta Shqiptare
Kontestohen	Kundërshtohen	Gazeta Shqiptare
Opsionet	Mundësitë	Gazeta Shqiptare

Prononcim	Deklaratë	Gazeta Shqiptare
Drastike	Rrënjësore	Gazeta Shqiptare
Performance	shfaqje	Gazeta Shqiptare
Oponent	kundërshtar	Gazeta Shqiptare
Impakti	Ndikimi	Gazeta Shqiptare
Atraktive	Tërheqëse	Gazeta Shqiptare
Rimburohet	dëmshpërblehet	Gazeta Shqiptare
Rimbursimi	Dëmshpërblimi	Gazeta Shqiptare
Indicio	Tregues	Gazeta Shqiptare
Konseguent	vijues/ vazhdues	Koha Jonë
Atraktive	Tërheqëse	Koha Jonë
Reality-show	Shfaqje	Koha Jonë
Intensive	i/e shpeshtë	Koha Jonë
Lukun	Paraqitjen	Koha Jonë
Implementimin	Zbatimin	Koha Jonë
Grant	Fond	Koha Jonë
Non – stop	pa pushim	Koha Jonë
Destinacion	Vendmbërritje	Koha Jonë
Permanente	e përhershme	Koha Jonë
Respektive	përkatëse	Koha Jonë
Asistuar	ndihmuar	Koha Jonë
Autenticitetin	vërtetësinë	Koha Jonë
E iniciuar	e filluar	Koha Jonë
Produktiv	i frytshëm	Koha Jonë
Networku	Rrjet	Koha Jonë
Komponente	Përbërës	Koha Jonë
Kondicionon	Kushtëzon	Koha Jonë
Workshop	Seminar	Koha Jonë
Imperative	e domosdoshme	Koha Jonë
Definitivisht	Përfundimisht	Koha Jonë
Lideri	Udhëheqësi	Koha Jonë
Riskun	Rrezikun	Shekulli
Draft	Projekt	Shekulli
Progresiste	Përparimtare	Shekulli
Avancuar	përsheptuar	Shekulli
Asistuar	Ndihmuar	Shekulli
Obligimet	Detyrimet	Shekulli
Konfidencial	i fshehtë	Shekulli
Maxhorancën	Shumicën	Shekulli
Liderit	Udhëheqësit	Shekulli
Limit	Kufi	Shekulli
Staf	Personel	Shekulli

Evidencat	Dokumentet	Shekulli
Lideri	Udhëheqësi	Korrieri
Investigimin	Hetimin	Korrieri
Lidershipit	Udhëheqjes	Korrieri
Mazhorances	Shumicës	Korrieri
Aferave	Çështjeve	Korrieri
Liderëve	Udhëheqësve	Korrieri
Destinacionin	vendmbërritjen	Korrieri

Përfundim

Me shembujt e mësipërm kemi paraqitur një problem madhor që na përket të gjithëve. Si çdo problem tjetër edhe ky ka zgjidhje madje duhet theksuar se ka më tepër se një. Është një problem që nuk e hasim vetëm ne prandaj dhe ia vlen të mësojmë nga përvoja e vendeve të tjera në këtë drejtim. Pikërisht në Mbretërinë e Bashkuar ekziston një institucion i posaçëm për miratimin e fjalëve të reja që i shtohen çdo ditë gjuhës angleze.

Së fundi, një drejtim ku mund të punohet nga Institucionet Gjuhësore është pikërisht thesari dialektor që ofron gjuha shqipe. Ka ardhur koha që pasuritë dialektore të shqipes të fillojnë të përdoren më tepër për pasurimin e gjuhës standarde. Mendoj se është pikërisht tek dialektet ku mund të gjejmë një burim mjaft të pasur fjalësh dhe shprehjesh në shqip që do të ndihmonin në pasurimin e mëtejshëm të leksikut tonë me fjalë shqip. Për këtë duhen bërë studime të thelluara të mundësive që ofrojnë këto dialekte për ushqimin dhe ripërtëritjen e vazhdueshme të shqipes me fjalë të reja.

Alarmi i albanologëve: Gjuha shqipe po vritet nga media!

Gjuhëtarët shqiptarë kanë lëshuar thirrjen “SOS” për gjuhën shqipe, kryesisht asaj që përdoret në media.

Importimi i fjalëve të huaja, gjuhë e varfër në shprehje dhe e shkruar larg standardit gjuhësor të pranuar, ishin disa nga problemet që u vunë re nga gjuhëtarët shqiptarë.

Pas një konference shkencore me temë “Gjuha e shtypit”, të zhvilluar në Institutin Albanologjik të Prishtinës, ku u konstatuan problemet e mëdha që has gjuha shqipe, e folur dhe e shkruar, në media, ata bënë një thirrje publike për reflektim dhe korrigjim.

Albanologët ofrojnë të paktën pesë zgjidhje imediate që do të ndërgjegjësonin mediat shqiptare në dy shtetet shqipfolëse, Shqipëri e Kosovë, që të jetë më e kujdesshme ndaj gjuhës.

Gjuhëtarët ofrojnë ndihmë direkt për organet e medias dhe sugjerojnë që të përcaktohet dhe në "ligjin për shtypin" përgjegjësia morale dhe ligjore e gazetarëve ndaj gjuhës shqipe.

Propozimet e albanologëve:

1. Në çdo organ shtypi ose radio a televizion të ketë një person të cilësuar për kulturën gjuhësore, i cili të shërbejë edhe si ndërlidhës me institucionet dhe organizmat shkencorë të gjuhësisë shqiptare. Ai do të ketë detyrë: a) të përcjellë tek adresa elektronike e Qendrës së Studimeve Albanologjike (Tiranë), e Institutit Albanologjik të Prishtinës, e Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare (Tiranë) ose e Shoqatës së Gjuhës Shqipe të Kosovës (Prishtinë) pyetjet e kolegëve për çështje të paqarta a të dyshimta, b) të pranojë vërejtjet e këshillimet e gjuhëtarëve dhe të veprojë për zbatimin e tyre në praktikë.

2. Të krijohet shoqata e redaktorëve letrarë / lektorëve të shtypit, e cila të organizojë me forma të përshtatshme kualifikimin e mëtijshëm e të vijueshëm profesional të tyre në bashkëpunim me organizmat shkencorë-mësimorë në fushën e gjuhësisë.
3. Degët e gazetarisë në universitet t'i japin rëndësi më të madhe formimit të thelluar gjuhësor të gazetarëve të ardhshëm dhe për këtë qëllim të përmirësojnë programet mësimore të lëndëve të gjuhës shqipe.
4. Në "Ligjin për shtypin" në Shqipëri dhe në Kosovë të shtohet një nen ku të formulohet në mënyrë të përshtatshme kërkesa për përgjegjësinë morale e ligjore që duhet të mbajnë organet përkatëse të shtypit në rast të shkeljeve të rregullave e normave gjuhësore, pa i mohuar askujt të drejtën që të përdorë edhe forma të tjera të gjuhës së shkruar, të ndryshme nga gjuha standarde.
5. Katedrat universitare të gjuhës shqipe ta përfshijnë më gjerë në veprimtarinë e tyre studimin e problematikës së gjuhës së shtypit, duke dhënë tema studimore nga kjo fushë e duke i bërë ato të njohura për praktikën.

Bibliografia

- Berisha, Ibrahim, 2009, *Media - agjensët e komunikimeve*, Pen-AAB, Botimi 3, Prishtinë.
- Desnickaja, Agnia, 1972, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, Prishtinë.
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1974.
- Doli-Kryeziu, Sindorela, 2013, *Shtrirja e shqipes standarde në Gjakovë*, Disertacion doktrate, Tiranë.
- Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1995.
- Fjalori i shqipes së sotme*, ASHSH - Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Toena, 2002.
- Hysenaj, Haki, 2012, *Shqipja e folur 40 vjet pas standardizimit të gjuhës*, Tiranë,.
- Memushaj, Rami, 2014, *46 vjet nga Konsulta e Prishtinës-lufta për njësimin e gjuhës*, Shqiptarja.com.
- Munishi, Shkumbin, 2013, *Përdorimi i shqipes në mediet audio-vizuale: çështje të përzgjedhjes së kodit*, Filologji 20, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Filologjisë, Prishtinë,.
- Musai, B.; Godole, J.; Abdurrahmani, T., 2011, *Edukimi mediatik*, Instituti Shqiptar i Mediave, Tiranë.
- Paçarizi, Rrahman, 2011, *Rruga e zhvillimit të shqipes standarde në raport me nevojat e komunikimit*, QSA, Tiranë.